

## THIRRJE PËR OFERTIM

### Realizimi i dokumentarit në kuadër të projektit “Eko Shkolla”

OJQ EC Ma Ndryshe me seli në Prizren është duke zbatuar projektin “Eko Shkolla” i cili është mundësuar nga ‘Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën’, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të avokojë për futjen e konceptit të EKO shkollës në shkollat e Prizrenit përmes pilotimit të modelit dhe metodologjisë përkatëse të mbrojtjes së mjedisit me pjesëmarrjen e gjerë të nxënësve dhe mësuesve në një shkollë të përgjedhur në mënyrë konkurente.

Në kuadër të këtij projekti do të realizohet një dokumentar – video material nëpërmjet të cilit do të dokumentohen intervenimet e realizuara në kuadër të projektit, ndërgjegjësimi qytetarë dhe shpërndarja e metodologjisë rreth konceptit të shkollave eko.

*Kushtet dhe detyrat e paracaktuara për kompaninë ofertuese:*

- Do të bëjë video-dokumentimin e aktiviteteve sipas udhëzimeve dhe kërkesave të stafit menaxhues të projektit ‘Eko Shkolla’
- Do të realizojë intervista me nxënsit e shkollës, mësimdhënësit e shkollës dhe individë të tjerë të përcaktuar nga stafi menaxhues i projektit
- Do të draftoj konceptin artistik dhe realizues të dokumentarit, duke specifikuar ecurinë e punës dhe etapat e nevojshme për realzimin e xhirimeve
- Do të jetë në dispozicion për të përcjellur aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit “Eko Shkolla”, për të cilat do të informohet paraprakisht nga stafi menaxhues i projektit
- Do të angazhohet të finalizojë montazhën

*Kriteret e perzgjedhjes:*

Gjatë shqyrtimit të ofertave, EC Ma Ndryshe do të ketë përbazë këto kritere të përzgjedhjes:

- Çmimi i volitshëm,
- Stafi permanent dhe bashkëpunëtorët e jashtëm
- Fleksibilitet gjatë gjirimeve dhe realizimit

*Të tjera:*

- Kompania e përgjedhur duhet të jetë e gatshme/në dispozicion për xhirime kur kërkohet nga punëdhënësi (gjatë muajit Maj - Qershor 2019)
- Të gjitha xhirimet do të bëhen në Prizren
- Kohëzgjatja e dokumentarit të prodhuar do të jetë rreth 10 minuta televizive

*Aplikimi:*

Ju lutem dërgoni ofertën tuaj financiare në zyret e organizatës **Ruga "Fehmi Lladrovci" 94, 20000 Prizren** apo në email adresën [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) dhe shkruani në subject “Ofertë për realizimin e dokumentarit për Eko Shkolla”, më së largu deri më **10 Maj 2019**, në orën **16:00**. Aplikacionet që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbyjnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen. Bashkë me ofertën tuaj financiare, ju lutem bashkëngjitni edhe këto dokumente: certifikata e regjistrimit të biznesit, certifikata e numrit fiskal, certifikata e TVSh-së ( kompanite që janë deklaruese të TVSH-së).

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga kompanitë nëse e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Për më shumë informacione rreth thirrjes për aplikim, ju lutemi viziton [www.ecmandryshe.org/konkurse](http://www.ecmandryshe.org/konkurse).